

Miqësia si
kategori politike

Friendship as
political category

Ekkehart
Krippendorff

Ekkehart Krippendorff

Miqësia si kategori politike

Friendship as political category

Heinrich Böll Stiftung Tirana, 2025

Miqësia si kategori politike

Miqësia e Vërtetë: Seminar i mbajtur nga 7 deri më 9 qershor 2002,
në *Haus auf der Alb*, Bad Urach

Ekkehart Krippendorff

Përkthyer nga gjermanishtja në shqip nga **Edwin Schwartz**

Friendship as political category

True friendship: A seminar held from 07 to 09 June 2002
at the *Haus auf der Alb*, Bad Urach

Ekkehart Krippendorff

Translated from German to English by **Eva Maria Volpe**



Aristoteli, filozofi i parë dhe në të njëjtën kohë, më i madhi si dhe më sistematiku i Perëndimit, vinte në dukje që në fillim të librit të tij mbi miqësinë (te libri VIII i së ashtuquajturës "Etika Nikomake") atë që thuhet zakonisht ndër të tjera në reflektimet e përunjura dhe aspak rigorozë mbi tema të tilla, se miqësia nuk para ka një dimension politik, ose se ajo mund të trajtohet "si një kategori politike", por se gjithashtu miqësia është më tepër se një kategori politike – e zhveshur nga aksesorët e saj psikologjikë, letrarë dhe përgjithësisht estetikë, – ajo mund të konsiderohet si kategoria qendrore e politikës në përgjithësi.

Sipas Aristotelit, miqësia "është jashtëzakonisht e nevojshme në lidhje me jetën (në bashkësi), sepse askujt nuk do t'ia kishte qejfi të jetonte pa miq, edhe nëse do t'i zotëronin të gjitha të mirat e tjera të marra së bashku". Është pikërisht ajo që "bën bashkë dhe i mban të lidhura të gjitha bashkësitë e qytet-shteteve", që shkon përtej "të mirave" dhe "përfitimit të ndërsjellë" për aq kohë sa "bashkësia e qytet-shteteve... nuk përpiket të nxjerrë përfitime të çastit, por për ato që e çojnë përpara jetën në tërësi". Pa miqësi nuk ka qytet-shtet, nuk ka politikë, dhe këtu bëhet fjalë plotësisht dhe provizorisht për jetën e ndërgjegjshme në bashkësinë publike.

"Miqësia karakterizohet më fort nga asgjë tjetër se sa të jetuarit së bashku: kur dikush që ka nevojë për ndihmë, do që të nxjerrë përfitime vetjake, por mbi të gjitha, njeriu që gjendet në nivelin më të lartë të lumturisë, kërkon shoqëri, sepse ai nuk duhet të kufizohet e të mjaftohet me vetveten të paktën." Si të thuash, miqësia është ajo që shkon përtej së përbashkëtës ose përfitimit të ndërsjellë përmes bashkëpunimit dhe gjërave që i shërbejnë përmbushjes së njëri-tjetrit, tepërcave krijuese që i japin zgjerimit sasior të aftësive dhe përfitimeve të kombinuara të njerëzve një cilësi të re, të paparashikueshme dhe krijuese.

Shprehja “të jetuarit së bashku” si kusht për mundësinë e miqësisë dhe rrjedhimisht, edhe të politikës, duhet të merret ashtu siç është, fjalë për fjalë: ajo krijon – kjo mënyrë e të jetuar së bashku – mundësinë e gjuhës e të fjalës. Aty ku mungon kjo gjë, ose zhduket për shkak të distancës së përhershme, atëherë edhe hapësira publike zhduket, e bashkë me të, edhe miqësia. Dhe anasjelltas: Aty ku zhduket miqësia si komunikim që duhet riprodhuar vazhdimisht, zhduket edhe ajo politike. Aristoteli ka shkruar: “Miqësia është shkatërruar shpesh herë nga mungesa e shkëmbimit të fjalëve.”

Po ju paraqes edhe një mendim tjetër, të fundit, nga Aristoteli: Njeriu “nga natyra” është “më i përshtatur me të përbashkëtat e dy vetëve se sa me polisin – popullsinë e qytet-shtetit (gjithëpërfshirëse)”, “bashkësia shtëpiake është më origjinale se sa polisi dhe mbart shumë më tepër karakterin e domosdoshmërisë; gjithashtu ajo shërben si nxitje për ta riprodhuar dhe ngulitur atë në qenien e gjallë në një mënyrë gjithëpërfshirëse.”

Familjet, bashkësitë shtëpiake dhe format e tjera të shoqërimit me synim përfitim të gjërave të nevojshme, janë të orientuara drejt qëllimit, – ato janë pragmatike, “të natyrshme” dhe e përmbajnë miqësinë vetëm në formën e saj më të ulët. Në të kundërtën, polisi, bashkësia politike, nuk është një produkt i natyrshëm, por ai është më tepër një vepër arti, një krijesë e njeriut, e njeriut-art, e “artit shoqëror”. Nuk ka pse të ekzistojë, – por aty ku ekziston, e kapërcen domosdoshmërinë natyrore (primitive) duke u shndërruar në një kategori morale: “Miqë e vrasin mendjen për t’i bërë mirë njëri-tjetrit”. Kështu që në epokën e grekëve të shekullit të 5-të dhe të 4-t para erës së re dhe para krishterimit, “politika”, diskutimet dhe bisedat për të mirat që ndajmë, zhvilloheshin në hapësirat publike. – Kaq për sa i përket Aristotelit!

Megjithatë, thënë kjo, koncepti themelor i asaj çka

përmban miqësia është konceptuar në atë mënyrë që i gjithë reflektimi i mëtejshëm sistematik sillet, si të thuash, vetëm rreth këtij vështrimi dhe përvoje të hershme evropiane, e përpunon atë, e zgjeron, i nxjerr në pah dallimin, e thellon, – por nuk e ndryshon më tej rrënjësisht. Gjithsesi, ky proces reflektimi mund, – dhe në fakt duhet, – të na çojë në një kuptim të qartë të asaj që përbën politikën, kur ajo duhet menduar në termat e miqësisë dhe përjetohet ose zbulohet përmes saj.

Para dhe mbi të gjitha, duhet të mendojmë për përkufizimin e miqësisë nga të folurit e nga biseda: Kjo nuk është medoemos e vetëkuptueshme dhe e dallon miqësinë në mënyrë delikate, por në të njëjtën kohë edhe qartazi, nga dashuria mes dy njerëzve, e cila, ashtu siç e kemi përjetuar të gjithë, të paktën në pika të caktuara, apo edhe siç e shpalos dhe e njeh letërsia dhe arti në përgjithësi, kur dy njerëz mund të komunikojnë me njëri-tjetrin edhe pa folur, duke mos pasur nevojë për gjuhën e folur në çdo kohë dhe që ndoshta në çastet e saj më të skajshme të lumturisë e të përmbushjes, mund të heshtë dhe duhet ta perceptojë të folurit si bezdi. Nga ana tjetër, miqësia është e ndryshme, – ajo rrjedh natyrshëm dhe vjen në vetvete, provohet dhe realizohet në bisedë e sipër, – ndoshta për këtë mund të përmendet si shembull “dialogu i çliruar nga shkenca”. Por ama biseda, mënyra se si njerëzit flasin me njëri-tjetrin, është ajo që i bën ata anëtarë të një bashkësie: politika mund të zhvillohet vetëm aty ku njerëzit mund dhe duan të flasin me njëri-tjetrin – që sigurisht nënkupton bisedën publike, për të përbashkëtën që i lidh ata mes vetes. – apo edhe si kërkim të së përbashkëtës – dhe jo shkëmbimin e pëshpëritur në mes të intimitetit apo ndarjes së sekreteve: kjo jo vetëm që nuk cilësohet si politike, por është madje edhe mohim i saj. Bisedat e miqve nuk i shmangen publikut dhe në mënyrë strukturore janë gjithmonë të hapura ndaj njëri-tjetrit, ndaj të tretëve ose të katërtëve dhe kështu ajo bëhet “qeliza fillestare” e politikës. Por miqësia është gjithashtu “qeliza parësore e politikës”

për aq kohë sa flitet me njëri-tjetrin, atëherë kur biseda është e prekshme publikisht dhe që mund të dëgjohet dhe të zhvillohet në mjedis të hapur. Kjo mbështetet në premisën aksiomatike që të gjithë pjesëmarrësit në këtë bisedë kërkojnë zgjidhjen më të mirë të mundshme që bashkësia – polisi, qyteti, vendi, shteti – ka nevojë dhe dëshiron dhe jo për përfitim vetjak, sepse në këtë kuptim, të gjithë janë miq. Dhe jo vetëm kaq: Aspekti politik i miqësisë pasqyrohet edhe në faktin se miqësia mund të ekzistojë vetëm aty ku tjetri njihet dhe pranohet si i barabartë: tjetërsia dhe trajtimi i barabartë, barazvlera e çështjeve juridike dhe pabarazia e subjekteve vetëm sa e bëjnë të mundur miqësinë, gjë që realizohet nga tjetërsia dhe kësisoj, e nxitur nga kureshtja e përhershme për këtë interes jo vetjak, miqësia ndizet edhe më tepër dhe riprodhohet. Por kjo është pikërisht ajo që përmban edhe kushtin për mundësinë e politikës: Arti i vetëkrijuar i të jetuarit bashkërisht me shumë të tjerë, me një mori njerëzish të ndryshëm, pranimi i dallimit dhe ndryshimit me të tjerët. Miqësia është e përbashkëta e përjetuar e shumëllojshmërisë – dhe po kështu është edhe politika, e cila fillon të ndalet aty ku barazia dhe homogjeniteti ngrihen në nivelin ideal të bashkësisë – qoftë ajo e një natyre etnike, racore, fetare apo edhe sociale.

Miqësia është gjithashtu – që nga zbulimi apo shpikja e saj greke si kusht për mundësinë e politikës si vetëvendosje e të barabartëve, – forca me të cilën thyhet (ose mund të thyhet) pushteti i të fuqishmit. Ia vlen të kujtohet fakti i jashtëzakonshëm se monumenti i parë politik që qytetarët e polisit athinas ngritën në agorën e tyre rreth vitit 510 p.e.s. iu kushtua një çifti miqsh: Harmodiosit dhe Aristogeitonit, të cilët kishin kryer vrasjen e Hiparkut, tiranit të Athinës, në vitin 514 p.e.s., vrasje që nga ana e saj (edhe pse dy miqtë humbën jetën përgjatë aktit e tyre) përgatiti terrenin për reformat e Kleistenit, të cilat vendosën themelet e demokracisë athinase. Kujtimi i kësaj dysheje miqsh ishte aq i rëndësishëm për qytetarët e Athinës, sa që u deshën të rridhnin më shumë se 100 vjet para se të

ngrihej publikisht një tjetër monument politik. Pra, edhe një herë, baza e politikës është miqësia, sepse ajo mund të njihet si marrëdhënie ndërpersonale horizontale në përgjithësi, ajo shprehet në bisedë, në fjalimin publik, në diskutimin e kauzës së përbashkët sipas asaj që është e mirë për bashkësinë e polisit, për atë çka ajo bën dhe demonstroi. Nga biseda në hapësirën publike lindin dije dhe njohuri për pjesëmarrësit në bisedë dhe merr formë ndërgjegjësimi – dhe pikërisht kjo përbën një sfidë për pushtetin, për ata që janë në pushtet, – ose, si në rastin e lashtë grek, për tiranët. Prandaj vendosja e monumentit politik të “Vrasësve të Tiranëve” (emërtimi i tanishëm i grupit të statujave, prej të cilave është ruajtur një kopje romake, që ndodhet në muzeun arkeologjik të Napolit) paraqitet si një lloj themelimi duke përbërë aktin e përbashkët të polisit. Platoni shkruan rreth kësaj (Simpoziumi 182c): “Mendoj se sundimtarët nuk përfitojnë nga njohuritë e mëdha që shfaqen në mes të të sunduarve, as nga miqësitë dhe lidhjet e forta (...) Por edhe tiranët vendas e kuptuan këtë gjë përmes veprimeve të tyre; sepse dashuria e Aristogeitonit dhe Harmodiusit, e cila u shndërrua në një miqësi të fortë, shkatërroi sundimin e tyre tiranik.”

Miqësia, si kategori politike, përbën gjithashtu një burim rezistence përmes së cilës thyhet forca e të fuqishmëve. Dikujt mund t'i vijë ndërmend gjithashtu balada popullore të Schillerit e titulluar “Die Bürgschaft” / “Garancia”, (e cila bazohet në një burim romak), ku një miqësi thyen dhe kthen mendjen e ngurtësuar të një mbreti dhe ai mendërisht heq dorë nga pozicioni i tij i spikatur si sundimtar: “Unë e kam vendin, dhe ma përmbushni kërkesën, në Kategorinë tuaj të Tretë.” Në fakt, kjo trajton edhe një herë të vërtetën e vlefshme në dukje, se pushteti mbi njerëzit dhe miqësia mes njerëzve janë reciprokisht ekskluzive, se të fuqishmit nuk mund të jenë edhe sundimtarë, edhe miq në të njëjtën kohë; se pushteti të bën të vetmuar, se siç thotë Montaigne, miqësia – “Lavdia kurorëzuese e shoqërisë” – i është mohuar sundimtarit.

Kjo rrjedh logjikisht – edhe nëse nuk kishte prova dërrmuese empirike për të mbërritur në këtë përfundim, – nga papajtueshmëria e marrëdhënieve vertikale dhe horizontale. “Princi,” – thonte Francis Bacon, një burrë shteti, erudit dhe eseist i epokës elizabetiane, – “duke pasur parasysh distancën midis pozicionit të tij dhe atij të shtetasve dhe shërbëtorëve të vet, nuk mund të vjelë e të këpusë dot frytin e miqësisë”. Dhe ata janë të vetëdijshëm për këtë, përfetojnë faktin se ky boshllëk shpirtëror ekziston në mënyrë ekzistenciale, edhe nëse nuk do të kishin mësuar, – ashtu siç patën fatin bashkëkohësit e Baconit, të brumoseshin me arsimin klasik, – nga Aristoteli se një jetë pa miq, në të vërtetë nuk ia vlente të jetonte, ose ndryshe duke e perifrazuar me fjalët e Baconit: “që lumturia e tyre, si ajo e një vdekatori, nuk iu dha kurrë, por atyre iu ofrua vetëm pjesërisht kur të pasurit vërtet një mik nuk ia përsosi dot atë. Ata ishin princa dhe sundimtarë që kishin gra, fëmijë dhe nipër, por kjo nuk u mundësoi të ndiheshin mirë, nuk ua dhuroi atë ndjenjë në shpirt që vetëm “Miqësia mund t’ua zëvendësonte.” Kjo është arsyeja pse ata krijojnë zëvendësime – politikanë, – ose biografi të sundimtarëve historikë. Ose (siç mund ta dinë edhe gazetarët hulumtues që kanë informacione të brendshme) që të fuqishmit e rrethojnë gjithmonë veten me njerëz të besuar, të cilët nuk krijohen në mënyrë kushtetuese apo institucionale, por ku në mes të tyre ai përpiqet të gjejë miq zëvendësues, ku mungon marrëdhënia e natyrshme, e hapur dhe e çiltër mes njerëzve, ku biseda mes të barabartëve është krijuar artificialisht dhe ku princat e sundimtarët, sipas Baconit, gjejnë apo sajojnë “disa njerëz për t’i lartësuar, si të thuash, deri të niveli i shokëve duke i trajtuar pothuajse si të barabartët e tyre. Në gjuhën e stome, njerëz të tillë quhen të preferuar ose të besuar, delfinë, sikur gjithçka të ishte një çështje favori apo shoqërie.” Por a është ky me të vërtetë një: “favor”, sepse qëllon që mund të biesh shumë shpejt nga fiku dhe t’i dalësh nga zemra nëse ti, si një gjoja mik, haptazi ose fshehurazi, shpreh shumë shpesh kritika. Në mbretërinë e përrallës së pushtetit, këtë

funksion të domosdoshëm dhe të padëshiruar e merrte përsipër, në mungesë të këtij dimension i themelor të njerëzimit, personazhi i gaztorit të paprekshëm të oborrit, duke paguar çmimin e pushtetit.

Por mes tyre, të fuqishmit, – duhet të jenë në gjendje të bëjnë miq, secili syresh i sigurt dhe i mbrojtur në pozicionin e vet, mbi baza të barabarta, nga princi në princ, nga presidenti në president. Natyrisht, pengesa e parë që qëndron në rrugën e këtij supozimi është fakti se nuk ka pothuajse asnjëherë ekuilibër real në marrëdhëniet midis shteteve dhe qeverive të organizuara ndërmjet njëri-tjetrit. Gjithmonë ka princa apo krerë të fuqishëm të shteteve të mëdha ekonomiksht, ushtarakisht, ose edhe gjeo-strategjiksht – në marrëdhënie përkatëse me njësi politike të vogla, të dobëta dhe të varfra; pabarazi të tilla janë rregull në botën historiksht të shumtë të shteteve të ndryshme. Mjafton të vëzhgosh gjuhën e trupit të presidentit amerikan, mënyrën se si sillët ai si i ftuar apo si mikpritës ndaj homologëve të tij të të njëjtit rang, për të kuptuar se kemi të bëjmë me një superfuqi përkundrejt superfuqisë së shteteve dytësore dhe satelite si dhe se kjo është një miqësi kolegjinale që as nuk mund të mendohet të jetë e njëjta gjë. Në shekullin e largët të 19-të, nën kushtet e solidaritetit dinastiko-aristokratik ndërmjet sundimtarëve, të cilët kishin lidhje gjaku dhe farefisnore me njëri-tjetrin, kjo ngjante dhe dukej disi si një miqësi vëllazërore, ndërsa në sundimin e fillimit të shekullit të 20-të gjermanët përdorën shprehje të tilla si: “I dashur Vili!” dhe “I dashur Niki!” kur i drejtoheshin njëri-tjetrit. Perandori dhe Cari rus luftuan kundër njëri-tjetrit dhe shpeshherë gjendeshin në kushte lufte e përballë shoqi-shoqit në fronte të kundërta. Analistët politikë nuk e kanë fare të vështirë ta kuptojnë këtë dhe të shohin përtej asaj çka përbën raportimin e përditshëm gazetaresk – kur ministrat, përdorin emrin e përveçëm kolegjal “Ju” kur iu drejtohen kryeministrave apo presidentëve dhe nxjerrin si përfundim se nga kjo mund të përcaktohen marrëdhëniet miqësore mes vendeve përkatëse.

Ju, analistët politikë, e dini se roli në strukturën tuaj përkatëse të pushtetit është më i rëndësishëm se momentet e situatës dhe atmosferike në punën e politikës së pushtetit: Nuk mund të mbështeteni e të nxirrni përfundime mbi këtë gjë, sepse miqësia nuk duhet ngatërruar me profesionalizmin mirëdashës e të kujdesshëm të protagonistëve në fjalë.

Kjo për shkakun se miqësia, për të ndërtuar mbi bazën e asaj që u tha më parë, ka nevojë jo vetëm për bisedim të hapur, por edhe kërkimin painteres të gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët dhe optimale për një bashkësi të caktuar. Dhe përveç faktit që bashkësia e madhe e të ashtuquajturës shoqëri botërore të shteteve, në të cilën takohen sundimtarët nuk ekziston si një horizont referimi: që të gjithë "burrat e shtetit" e monitorojnë me shumë kujdes njëri-tjetrin dhe mundohen të zbulojnë pikat e forta dhe të dobëta të secilit prej tyre; ata e njohin njëri-tjetrin kur sillen si ekspertë në mbajtjen dhe ruajtjen e pushtetit si dhe e respektojnë njëri-tjetrin vetëm për shkak të kësaj gjëje, – por miqësia e tyre përfundon aty ku mbaron fuqia e tjetrit. Burri i pushtetshëm i djeshëm është më i rëndësishëm se sa ai që e ka humbur fuqinë sot dhe është përmbysur nga sundimi, sepse nuk ka më përreth asnjë nga të ashtuquajturit miqtë e tij dhe shpesh kthehet në një pré të përndjekur, duke u trajtuar me përbuzje sikur ta kishte zënë lepra. Në rrethin e atyre që janë në pushtet, fjala "mik" është një emërtim plot helm: A ka dëgjuar ndonjëherë dikush që protagonistët e mëdhenj të brezave të shkuar të shtetarëve ta shohin e ta konsiderojnë njëri-tjetrin sërish si miq politikë pasi kanë dalë në pension? Kur diçka e tillë ndodh, ajo ngjet brenda grupit profesional që është përgjegjës për të kundërtën e miqësisë, pra armiqësinë e organizuar, sepse ka diçka që quhet etikë profesionale: Po flasim në këtë rast për ushtrinë, e cila e merr sërish veten dhe rimëkëmbet pas humbjeve apo fitoreve të luftërave. Nuk është e pazakontë që të shtrini dorën mbi varret e viktimave që keni shkaktuar një herë e një kohë:

Ju keni ushtruar dikur profesionin tuaj, keni luftuar – në emër të politikës, – por kurrë (ose rrallë herë) i nxitur dhe duke shpalosur pretendimin e urrejtjes personale dhe për rrjedhojë, jo duke përdorur thirrjen për pajtim, për miqësi. Njerëzit e shohin njëri-tjetrin si kolegë, vlerësojnë kompetencën teknike përkatëse të zgjidhjes së konfliktit të organizuar, – por ata nuk angazhohen që të përfshihen në dialog me njëri-tjetrin, nuk bëjnë bisedime dhe nuk kanë më pretendime për politikë, pra as për miqësi.

Ndoshta ka kaluar pa u vënë re, por ka ndodhur një zhvendosje specifike në problemin e miqësisë dhe politikës është bërë duke pasur parasysh konsideratat e fundit: nga teza – shpresoj e bazuar dhe e menduar mirë mbi konceptin – e miqësisë si kategori politike e demokratëve, vetëvendosja (autonomia) është gur themeli i shoqërisë civile, dhe papritur është krijuar një tension, për të mos thënë një kontradiktë mes politikës dhe miqësisë. Zgjidhja për këtë përdorim kontradiktor të emërtimeve të dyfishta miqësi/politikë është se në rastin e fundit, përdorimi tradicional i termit “politikë” është, në një farë mase, jo reflektues i saktë i emërtimeve, për atë çka kuptojmë me politikë në të folurin e përditshëm dhe si vëzhgues pasivë. Mirëpo, qëllimi i këtyre konstatimeve ishte pikërisht të vihej në dyshim apo të nëpërkëmbej kjo miqësi si të ishte një kategori e politikës – jo e politikës! Dhe – kjo nuk duhet të na shpëtojë nga vëmendja, – sepse është këtu dhe sot ajo që ka më shumë rëndësi është të kujtojmë kuptimin e harruar ose disi të “mjegulluar” të konceptit të vërtetë të politikës.

Na duhet të risjellim ndër mend, për hir të sqarimit shterues, një emërtim të lidhur drejtpërdrejt, madje mund të thuhet pothuajse konkurrues, i cili nga ana e tij, historikisht, është shndërruar në një term të fortë e me mjaft peshë, por që shpreh pikërisht atë që bie ndesh me natyrën politike të miqësisë: Vëllazërinë. “Liria – Barazia – Vëllazëria” ishin idealet e mëdha me anë të së

cilave Revolucioni Francez i bëri thirrje botës politike të Evropës për një fillim të ri të vetëvendosjes. Ajo ishte kredoja e tij republikane dhe është ende e tillë edhe sot e kësaj dite, ndonëse nuk theksohet më me të njëjtën forcë si dikur. Përveç faktit që "fraternité" / "vëllazëria" është qartësisht e natyrës mashkullore, ajo përfshin edhe lidhjen familjare; një marrëdhënie biologjike, lidhjet e gjakut dhe klanit. Pikërisht kjo është ajo çka përbën thelbin e miqësisë, të përcaktuar politikisht, faktin që i çliron marrëdhëniet ndërpersonale nga lidhje të tilla natyrore, i tejkalon ato dhe e rindërton antropologjikisht bashkësinë në një mënyrë krejt të re e të ndryshme – pikërisht politikisht. Polisi nuk është një bashkësi gjaku e marrëdhëniesh ekskluzive farefisnore, por një rend i bazuar në arsyen, dijen, ndërgjegjësimin, shkëmbimin e ideve dhe pikëpamjeve dhe mbi të gjitha, në "tjetërsinë" përkatëse, mbi dallimin dhe shumëllojshmërinë. Miqësia është neutrale ndaj përkatësisë etnike, racore, klasore dhe fetare, – kjo vlen si në sferën private, ashtu edhe në atë publike dhe politike. Ky është dinjiteti dhe arritja e tyre njerëzore.

Dhe miqësia është pikërisht kjo gjë: Një arritje, diçka që nuk na vjen si dhuratë, por që do dhe që ka nevojë të përpunohet dhe të ripohohet vazhdimisht. E gjithë miqësia është rezultat i mundimeve të bëra dhe mund të ruhet vetëm përmes përpjekjeve të ndërsjella. Kjo vlen si për shkallën e vogël të miqësisë individuale, ashtu edhe për shkallën e madhe të miqësisë dhe kategorinë qendrore të saj, atë politike. Aty ku neglizhohet "puna e marrëdhënies" neglizhohet ose akoma edhe më keq, nëse krijohet mbi bazën e supozimit përtac se miqësia është e vetëkuptueshme dhe mund të arrihet në çdo kohë, atëherë ajo humbet dhe papritmas nuk është më aty kur të nevojitet. Nuk është rastësi që gjejmë dëshmi të thella të reflektimit mbi miqësinë si qelizë parahistorike e politikës në lashtësinë greko-romake. Pra, atje, ku politika u zbulua fillimisht si një shpikje duke u praktikuar më pas në mënyrë republikane për tre deri në katër shekuj, – dhe pastaj përsëri në Rilindje

me esetë madhështore të Francis Bacon dhe Michel Montaigne: Ndërkohë, për gati një mijëvjeçar e gjysmë, politika u harrua. Vërtetë u bë ose u zbatua politika e madhe, – por u bë ama pa politiken si mënyrë jetese, si praktikë ligjërimi publik, si republikë. Nga periudha e së ashtuquajturës “Mesjetë” vetëm në teologji hasim dëshmi dhe pohime si: “Miqësia me Zotin” shembulli B. nga abati skocez sistersian dhe shenjtori Aelred von Rieval (në përmbledhjen e vyer “Philosophy of Friendship” / “Filozofia e Miqësisë”, Reclam 1999).

Me fjalë të tjera, ky element politik, vetëvendosja e qytetit apo e shtetit, thjesht ishte harruar (sepse nuk kultivohej dhe nuk ushqejhej më sistematikisht) dhe ishte zhdukur fare nga ndërgjegjja publike. Rilindja evropiane ishte gjithashtu një rilindje në atë kuptim që, duke e parë sferën publike si hapësirë njerëzore, e shihte edhe miqësinë si arritjen dhe realizimin e njerëzimit të rizbuluar.

Tashmë filli i atyre që kanë menduar për miqësinë nuk këputet më. Gjatë Iluminizmit, reflektimi arriti një kulm të pakrahasueshëm për atë kohë, dhe ajo gjë nuk ishte rastësi, pasi ajo periudhë dominohej tërësisht nga të drejtat e njeriut duke kapërcyer modelet farefisnore, lidhjeve familjare dhe shembujt e tjerë “natyrorë” të shoqërisë dhe politikës. Hannah Arendti, filozofja e epokave të errëta, theksoi në fjalimin e saj gjatë ceremonisë së marrjes së çmimit “Hamburg Lessing” në vitin 1959 se “Natani” mund të quhet “loja klasike e miqësisë”. Dhe në fakt: Lessingu shkon deri në prapësinë e dhimbjes së asaj që është krijimi plot durim dhe i besueshëm në mënyrë dramatike i një drame që të gjithë protagonistët miq, madje edhe ata që ndihen më të largët nga njëri-tjetri, – si kusht për të arritur mundësinë e tolerancës dhe shumicës. Rrallëherë mund të hasen kaq shumë mendime të thelluara dhe argumente në një dramë, – nga pikëpamja metodologjike flasim, – pjesë kyçe e modernizmit politik, sa tek “I Mençuri Natan”.

Tema politike e miqësisë nuk është aspak e shteruar.

Edhe një herë tjetër, burimi është thelbësor dhe na ndihmon pamasë. "Asgjë nuk e karakterizon miqësinë më shumë se sa të jetuarit së bashku," – shkruhet në të, duke vazhduar se: "Miqësia me shumë njerëz nuk është e mundur të arrihet në kuptimin e miqësisë së përsosur." Fjalimi i marrë nga "Të jetosh së bashku" mbi ata "që e kalojnë jetën së bashku, kënaqen me njëri-tjetrin dhe i japin shoqi-shoqit gjëra me vlerë" i referohet një dimensionit politik, që është i përjashtuar nga diskutimi i mëtejshëm mbi këtë temë dhe as që mund të perceptohet: dimensionit hapësinor i politikës. Për Aristotelin, dhjetë vetë ishin pak dhe 100,000 të tjerë qenë më shumë nga ç'duhej për të formuar një polis.

Dikush mund të argumentojë për numrat në mënyrë sasiore, – por gjëja më e rëndësishme cilësisht në lidhje me këto pretendime është vetëdija se duhet të ketë dhe ka një kufi, përtej të cilit miqësia dhe politika nuk mund të funksionojnë më: Që të dyja kanë nevojë për një minimum të administrimit të dimensioneve të mundshme njerëzore, të kontakteve të personalizuara dhe sistemeve të komunikimit që përmbushin fjalën e rëndësishme politikisht dhe të përdorur më tepër nga ç'duhet – "përgjegjësi". Përgjegjësia, ashtu si miqësia, kërkon administrim. Edhe një shtet i madh kombëtar, e lëre më pastaj një Bashkim Evropian, i qeverisur administrativisht nga Brukseli, është shumë i madh për ta përcaktuar qartë përgjegjësinë. Kjo vlen edhe për bashkitë urbane, që gjenden në shumicën e rajoneve nën përgjegjësinë e shteteve kombëtare, për të cilat është deri diku e mundur dhe pothuajse plotësojnë pretendimin normativ të miqësisë dhe diskutimit politik. Aty ku përgjegjësia nuk është e mundur dhe mund të cenohet, edhe miqësia s'është e mundur – si dhe anasjelltas.

Një tjetër ide e mrekullueshme që e kemi marrë nga Aristoteli dhe për të cilën udhëheqësit duhet ta vrasin mendjen e të thellohen edhe më tej është: "Asnjë mik pa kohë", – thotë "Etika Eudemike", dhe Jacques Derrida, i cili iu referua në studimin e vet të titulluar "Politika e miqësisë", shpjegon: "Asnjë mik pa kohë, pra pa atë që e

vë në provë besimin. Nuk ka miqësi pa besim; dhe asnjë besim që nuk matet me një kronologji, që nuk matet dot me vetveten, kohëzgjatja e të cilit nuk i reziston kohës nuk do të kishte vlerë. Përfshirja në miqësi dhe angazhimi i kryer në të kërkon kohë. Ato kanë nevojë për kohë, sepse shtrihen përtej momentit të tanishëm dhe përfshijnë kujtesën si edhe pritjen. "Lidhjet me 'besueshmërinë', 'probabilitetin', 'përvojën' e 'vënë në sprovë', 'të provuar', etj., lindin dhe u japin jetë shumë shpejt – koncepteve të të gjitha kohërave.

Miqësia ndonjëherë mund të lindë që "në shikimin e parë", por për t'u shndërruar në një të tillë si dhe për t'u bërë konstante e njerëzimit, ajo duhet të hedhë shtat dhe kërkon përkujdesje e mëkim të kësaj rritjeje. Në këtë mënyrë rezulton edhe një kategori e politikës: Kjo kërkon kohë në kuptimin e autonomisë së vetëdijshme, të vetëvendosjes së komunitetit nga bashkësia e qytetarëve, gjë që përmendet këtu vazhdimisht. Demokracia, qeverisja e përbashkët e shumicës (popullit), është gjithashtu shpikja dhe zbulimi i kohës për marrjen e vendimeve. Demokracia ngadalëson vendimet që janë të nevojshme, sepse ajo që është më e rëndësishme se sa vendimi aktual është procesi i gjetjes dhe formimit të tij, arsyetimi, peshimi i argumenteve, kërkimi i zgjidhjes më të mirë të mundshme si dhe shmangia e zgjidhjes së rrezikshme. Dhe pikërisht nga ky proces të formimit të opinionëve dhe gjykimeve në hapësirën publike lind vetëbesimi i njerëzve të përfshirë në njëri-tjetrin dhe në kuptimin politik, këtu lind miqësia. Në një të ardhme afatgjatë dhe për të gjitha, por në të cilën, duke hedhur shikimin pas, ne mund të besojmë për ta krijuar atë çdo herë sërish – si punë në politiken, por gjithmonë me vetëdijen se një miqësi e tillë përfshin edhe njohjen e vazhdueshme të tjetërsisë, dallimit dhe shumicës në bashkësi, prandaj do të lindin miqësitë e reja, domethënë plejadat politike. Miqësia nuk është më një gjendje e përhershme, sepse ajo mbështetet në harmoninë e plotë të shpirtave – ajo është, dhe kjo nuk është vetëm një mënyrë e të folurit "politikisht",

vënia në pikëpyetje e kohëzgjatjes dhe reflektimi i vazhdueshëm për dallimet. Por që të dyja pikëpyetjet dhe reflektimi janë veprimtari aktive e krijuese dhe kërkojnë një përpjekje të pandërprerë për të punuar me marrëdhëniet. E kundërta e miqësisë nuk është armiqësia, por mospërfillja.

Nëpërmjet mospërfilljes vdes jo vetëm miqësia, por edhe njerëzimi, i cili konsiston në interesimin për të tjerët, përkujdesjen për ta dhe problemet e tyre dhe gjithashtu hyrjen në një marrëdhënie. Por kjo është shfaqja e politikës në histori: Vetëdija e marrëdhënieve në bashkëbisedimin mes njerëzve rreth botës që ata dhe ne, së bashku duhet të krijojmë e t'i japim formë.

O
N

F
R
I
E
N
D
S
I
H
N
E

M
B
I
M
I
Q
E
S
H
I
P





At the very beginning of his book on friendship (Book VIII of the Nicomachean Ethics), Aristotle, the first and at the same time the greatest systematic philosopher of the West, stated what he would say with these modest and hardly rigorous considerations on the subject: namely that friendship neither has a political dimension nor can be treated "as a political category", but rather that friendship is a political category - stripped of its psychological, literary and generally aesthetic accessories, it is a central category of politics in general.

Friendship, according to Aristotle, "is highly necessary for life in the community. No one would want to live without friends, even if he possessed all the other goods." It is what "holds the polis communities together", far beyond the "benefits" and the "mutual advantage". The "polis community ... does not strive for the advantage of the moment, but for that which advances life as a whole". Without friendship, there is no polis, and no politics, which is here understood, provisionally, as conscious life in a public community.

